**VENDIM**
**Nr. 62/2021**

# PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE, PËR ANËTARË ZËVENDËSUES, PËR POZICIONET KOMISIONER TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT DHE KOMISIONER PUBLIK

Në mbështetje të neneve 10 dhe 11, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 17, pika 8, të vendimit të Kuvendit nr. 40/2017, "Për procedurat parlamentare për funksionimin e komisioneve *ad hoc* dhe realizimin e procesit të votimit sipas ligjit nr. 84/2016, 'Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'"; bazuar në raportin e komisionit *ad hoc* të përzgjedhjes me 12 anëtarë, krijuar sipas vendimit të Kuvendit nr. 60/2021, "Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit Parlamentar *ad hoc,* me 12 anëtarë, për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë zëvendësues për pozicionet komisioner të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisioner Publik",

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e listës së kandidatëve të zgjedhur, për anëtarë zëvendësues, për pozicionet komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Komisioner Publik, si më poshtë:

1. Zonja Rozeta Ivanova zëvendësuese për pozicionin komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
2. Zonja Irena Nino zëvendësuese për pozicionin Komisioner Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.7.2021.